

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të
Auditimit të Brendshëm
Internal Audit Knowledge
Elements**

B1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 30/01/2022

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Për sa i përket parimeve etike, cila nga opsionet e mëposhtmet e përcakton siç duhet parimin profesional?
 - A. Parimi profesional thotë se një person i vërtetë do t'i bëjë gjërat në atë mënyrë që, ai ose ajo të mund t'i shpjegojë ato përpara një komiteti bashkëmoshatarësh.**
 - B. Parimi profesional do të thotë që punonjësit bëjnë gjëra për të mirën e organizatës.
 - C. Parimi profesional do të thotë që e mira më e madhe duhet bërë për të mirën e përgjithshme.
 - D. Parimi profesional është aplikimi i njohurive, aftësive dhe gjykimit të shëndoshë në përdorimin e burimeve të organizatës.
2. Në mbikëqyrjen e sjelljes ligjore dhe etike të një korporate, cila nga opsionet e mëposhtme NUK është një element i mbikëqyrjes të sjelljes ligjore dhe etike nga bordi?
 - A. Konfliktet e interesit.
 - B. Rezistenca e biznesit.**
 - C. Transaksionet me palët e lidhura.
 - D. Programi i pajtueshmërisë.
3. Lidhur me rolet e drejtuesve kryesorë ekzekutivë dhe të drejtuesve të lartë, një korporatë duhet të ketë një kod të sjelljes me mekanizma efektivë të raportimit dhe zbatimit si pjesë e cilit program/plan nga opsionet e mëposhtme?
 - A. Programit të pajtueshmërisë.**
 - B. Planeve strategjike.
 - C. Planeve operative.
 - D. Programit të rrezikut.
4. Për sa i përket të drejtave të njeriut, kur njerëzit pranojnë rregulla nga autoriteti legjitim në këmbim të sigurisë dhe përfitimit ekonomik cilës nga opsionet në vijim i referohet?
 - A. Kontratës sociale.**
 - B. Kontratës ekonomike.
 - C. Kontratës së sigurimit.
 - D. Kontratës së punës
5. Cilët nga të më poshtmit NUK përfshihen në grupin e 'rojtarëve' të një korporate?
 - A. Kontabilistë.
 - B. Auditorët.
 - C. Menaxherët dhe drejtuesit.**
 - D. Avokatët.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

6. Nga të gjitha palët e listuara, cili nga sa vijon është shpesh faktori kryesor i rënies organizative?
- A. Konkurrentët.
 - B. Punonjësit.
 - C. Menaxhmenti.**
 - D. Investitorët.
7. Në kryerjen e një auditimit të etikës, zyrtari kryesor i etikës ose i/e emëruari/a e tij/saj NUK kryen cilën nga detyrat si në vijim:
- A. Të mbaj orë të trajnimit për personelin meanxhues dhe jo-menaxhues për parimet e etikës që përfshinë veprimet dhe pasojat.
 - B. Analizimin e pikëpamjeve të palëve të jashtme për palët e brendshme dhe pikëpamjeve të palëve të brendshme për palët e jashtme për të identifikuar shkëputjet midis këtyre pikëpamjeve dhe për integrimin e tyre në mënyrë koherente.
 - C. Të punoj me departamentin e auditimit të brendshëm në zhvillimin e planeve të auditimit dhe identifikimin e fushave të auditimit duke i adresuar shkeljet etike.
 - D. Të kryej auditime ligjore, rishikime speciale të menaxhmentit periodikisht dhe në mënyrë pro-aktive për të siguruar përmirësime të vazhdueshme.**
8. Vlerësimi i rrezikut është procesi i parë në metodologjinë e menaxhimit të rrezikut. Aktivitetet kryesore në procesin e vlerësimit të rrezikut përfshijnë:
- A. Identifikim e dobësive dhe eliminimin e rrezikut.
 - B. Identifikimin e dobësive, identifikimin e kërcënimeve, analizën e kontrollit, analizën e ndikimit, vendosmërinë e rrezikut dhe rekomandimet e kontrollit.**
 - C. Përcaktimin e prioriteteve, vlerësimin dhe zbatimin e kontrollit të duhur për reduktimin e rrezikut
 - D. Tolerancën e rrezikut dhe oreksin e rrezikut.
9. Në menaxhimin e rreziqeve që i kanosen një biznesi, menaxhmenti i lartë përdor metodologjitë në dispozicion për të zbutur rreziqet e biznesit. Cila nga opsionet e më poshtme NUK është një zgjedhje e mençur, zakonisht jo praktike apo gati e pa mundur për t' u përdorur në zvogëlimin e rrezikut:
- A. Refuzimi i rrezikut**
 - B. Shmangia e rrezikut
 - C. Reduktimi i rrezikut
 - D. Kontigjenca e rrezikut

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

10. Ekzistojnë shumë rreziqe të cilat i kanosen bizneseve. Shumë nga këto rreziqe kanë relacion të ndërsjellët dhe kanë efekt zmadhues. Cila nga opsionet e mëposhtme të rreziqeve, po të ndërlidheshin zmadhojnë rrezikun e reputacionit të ndërmarrjes.
- A. Rreziku ligjor dhe rreziku rregullator**
 - B. Rreziku financiar dhe rreziku ligjor
 - C. Rreziku i kapitalit njerëzor dhe rreziku i shkaktuar nga menaxhmentit
 - D. Rreziku financiar dhe ekonomik
11. Tradicionalisht menaxhimi i rrezikut është fokusuar në rrezikun e pjesshëm të portfolios, ndërsa tani menaxhimi i rrezikut të ndërmarrjes fokusohet në rrezikun e portfolios së përgjithshme. Cilat nga opsionet e mëposhtme përfshinë të gjitha rreziqet që konsiderohen rreziqe të portfolios së përgjithshme?
- A. Rreziqet financiare dhe rreziqet hazarde.
 - B. Rreziqet financiare, rreziqet hazarde, rreziqet strategjike dhe rreziqet operacionale.**
 - C. Rreziqet e kapitalit njerëzor, rreziqet strategjike, rreziqet e prodhimitarisë dhe të procesit.
 - D. Rreziqet operacionale, rreziqet organizative dhe rreziqet e tregtimit.
12. Matja e rrezikut të një biznesi mund të jetë e vështirë. Në praktikë, përdoren një shumëllojshmëri e qasjeve për të menaxhuar rreziqet. Disa nga mjetet dhe teknikat më të zakonshme që përdoret përfshijnë metodat cilësore dhe metodat sasiore. Të gjitha sa vijon janë shembuj të metodave cilësore, përveç:
- A. Listave kontrolluese.
 - B. Përcaktimit subjektiv të rezultateve**
 - C. Qasje intuitive.
 - D. Vetëvlerësimeve.
13. Cila nga mjetet alternative të transferimit të rrezikut mund të zbatohet në kompanitë e sigurimit dhe risigurimit si pjesë e programit të menaxhimit të rrezikut të një kompanie?
- A. Kontratat e linjave të shumta
 - B. Politikat e aktivizimeve të shumë fishta
 - C. Kontratat financiare të sigurimit**
 - D. Rreziku i sekuritizimit
14. Çmimet e qëndrueshme, konkurruese dhe luftërat e çmimeve janë të dyja të zakonshme në cilën nga fazat e mëposhtme të ciklit jetësor të produktit?
- A. Fazën e pjekurisë.**
 - B. Fazën hyrëse.
 - C. Fazën e rritje.
 - D. Fazën e rënies.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

15. Struktura e një organizate në përgjithësi ndjek strategjinë e saj të përgjithshme. Në njërin anë janë organizata organike të strukturuar lirshëm. Në anën tjetër janë organizata shumë të centralizuara, me shumë kontrole, mekanike.

Një kompani mban një zinxhir pikash të shitjes në stilin e magazinës. Këto pika shesin vëllime të larta ushqimi, pajisje zyre dhe mallra të tjera relativisht të lira. Shpenzimet e marketingut janë minimizuar dhe çdo dyqan është i mobiluar thjeshtë. Zgjidhni opsionin strukturor më të përshtatshëm për këtë organizatë.

A. Mekanike.

B. Imitative.

C. Organike.

D. Holistike.

16. Zëvendës drejtori i auditimit të brendshëm kërkon nga stafi i auditimit respektim të rreptë të programeve të auditimit të parashkruara dhe planeve të përcaktuara të auditimit; asnjë përjashtim nuk tolerohet. Puna e auditimit është planifikuar bazuar në një cikël trevjeçar të firmës. Statistikat mujore përpilohen dhe i dërgohen të gjithë stafit. Këto statistika përdoren për të vlerësuar performancën, për të treguar buxhetin kundrejt të dhënave aktuale për kohën e punës, nxjerrjen e raporteve dhe gjashtë masa të tjera. Kjo qasje e menaxhimit të zëvendës drejtorit përshkruhet më së miri si:

A. Qasja operacionale.

B. Qasja e sjelljes.

C. Qasja sistemore

D. Qasja kontingjent

17. Me zhvendosjen e ekonomive të disa shteteve drejt industrive të shërbimeve, është zhvilluar një formë e re organizimi. Kjo strukturë organizative quhet burokracia profesionale. Ndërsa kjo strukturë i ngjan burokracisë mekanike në disa aspekte (e cila mbështetet në proceset e standardizuara të punës), ajo është e ndryshme në një aspekt kyç nga burokracisë mekanike. Ky ndryshim domethënës është se në një burokraci profesionale:

A. Menaxhmentit të lartë i është dashur të heqë dorë nga një sasi e konsiderueshme e kontrollit.

B. Detyrat kryhen me një shkallë të lartë efikasiteti.

C. Ka respektim të rreptë të rregullave.

D. Ekziston një tendencë për zhvillimin e konflikteve të nën-njësive.

18. Cilat mekanizma NUK ndihmojnë për të koordinuar ndarjen e detyrave në një organizatë?

A. Ndarja e punës.

B. Departamentizimi.

C. Procedurat standarde të funksionimit.

D. Hierarkia administrative.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

19. Një firmë e vogël prodhimi mobiljesh me 100 punonjës ndodhet në një ndërtesë dykatëshe dhe nuk planifikon të zgjerohet. Mobiljet e prodhuara nuk janë të porositura ose të bëra me porosi. Duke marrë parasysh këto fakte, struktura më e zakonshme për këtë organizatë do të ishte:
- A. Departamentizimi funksional.**
 - B. Departamentizimi i produktit.
 - C. Organizimi i matricës.
 - D. Organizimi i divizionit.
20. Mënyra se si struktura e një firme lidhet me mjedisin në të cilin operon firma është e rëndësishme për suksesin e një firme. Struktura e një firme mund të jetë mekanike (një organizatë e ngurtë në formë piramide) ose organike (një organizatë fleksibël dhe adaptive). Cili nga opsionet e mëposhtëm nuk është karakteristik për ndërveprimin midis mjedisit të një firme dhe strukturës së saj?
- A. Sa më dinamik të jetë mjedisi, aq më shumë struktura e firmës duhet të jetë organike.
 - B. Sa më kompleks të jetë mjedisi, aq më shumë struktura e firmës duhet të jetë mekanike.**
 - C. Sa më i qëndrueshëm të jetë mjedisi, aq më shumë struktura e firmës duhet të jetë mekanike.
 - D. Sa më i vogël të jetë mjedisi, aq më shumë struktura e firmës duhet të jetë organike.
21. Cilën nga strukturat e mëposhtme organizative përdorin më shpesh kompanitë globale për të arritur koordinimin e njëkohshëm të produkteve në të gjithë vendet?
- A. Departamentet funksionale.
 - B. Departamentizimit.
 - C. Strukturën organizative të matricës.**
 - D. Strukturën organizative të bazuar në produkt.
22. Cili është avantazhi kryesor i strukturës organizative të matricës?
- A. Unitet më i madh komandues.
 - B. Rritje e koordinimit.**
 - C. Kosto më e ulët.
 - D. Komunikim me cilësi më të lartë.
23. Kur trajtohen furnitorët dhe shitësit, çfarë lloj zinxhiri përfshihet kur veprimet e një menaxheri blerjeje lidhen me performancën?
- A. Zinxhiri i llogaridhënies.**
 - B. Zinxhiri i vlerës.
 - C. Zinxhiri i furnizimit.
 - D. Zinxhiri i performancës.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

24. Kur trajtoni agjentëte blerjes/blerësit dhe marketingun/shitësit, praktikat e paligjshme dhe jo-etike duhet të lidhen me cilën nga sa vijon?
- I. Rregullat e blerjes së një kompanie.
 - II. Manuali i blerjeve të një kompanie.
 - III. Një kod i etikës profesionale.
 - IV. Deklarata e kodeve të sjelljes së një kompanie.
- A. I dhe II.
B. II dhe III.
C. III dhe IV.
D. I, II, III dhe IV.
25. Cila nga opsionet në vijim mund të përkufizohet si kombinim i përfitimeve të marra dhe kostove të paguara nga klienti?
- A. Përfitimet e klientit.
 - B. Shpërndarja e vlerës.**
 - C. Kompensimi kosto-përfitim.
 - D. Sinergia dhe shkëmbimi i strukturës.
26. Cila është arsyeja kryesore që një organizatë duhet të monitorojë mjedisin e jashtëm (të gjerë)?
- A. Për të parashikuar shqetësimet dhe tendencat.**
 - B. Për të përcaktuar pikat e forta të brendshme të firmës.
 - C. Për të përcaktuar dobësitë e brendshme të firmës.
 - D. Për të identifikuar punonjësit ose burimet kryesore brenda firmës.
27. Të pohimet e mëposhtme janë të vërteta për pasigurinë mjedisore, përveç njërit pohim:
- A. E bën më të vështirë marrjen e vendimeve menaxheriale.
 - B. Organizatat e marrin pjesën më të madhe të ndikimit të tyre drejtpërdrejt nga mjedisi i jashtëm.**
 - C. Pushteti politik ndikon në organizatë.
 - D. Fuqia ekonomike ndikon në organizatë.
28. Cili është qëllimi kryesor i strategjisë së integritit vertikal?
- A. Kontroll total i një produkti nga koncepti te klientët.**
 - B. Rritja e kontrollit mbi cilësinë e furnitorëve.
 - C. Mundësi më e madhe për diferencimin e produktit.
 - D. Rritja e kontrollit mbi mënyrën se si tregtohet një produkt.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

29. Cila nga opsionet në vijim është një disavantazh i integrimit vertikal?
- A. Shpenzimet administrative.
 - B. Shpenzimet e shitjes.
 - C. Kostot e kërkimit dhe zhvillimit.
 - D. Kostot e prodhimit.**
30. Një firmë që mund të zotërojë një fazë të zinxhirit të furnizimit të industrisë nuk do të shkëlqejë domosdoshmërisht në fazat e tjera. Për këtë arsye, shumë firma shmangin cilën nga strategjitë e mëposhtme?
- A. Integrimin vertikal.**
 - B. Diversifikimin.
 - C. Ristrukturimin.
 - D. Integrimin horizontal.
31. Procesi i menaxhimit strategjik nuk përfshin cilin nga sa vijon?
- A. Planifikimin e prodhimit.**
 - B. Analizën e mjedisit.
 - C. Formulimin e strategjive.
 - D. Zbatimin e strategjive.
32. Cila është marrëdhënia më logjike midis një avantazhi të qëndrueshëm konkurrues dhe një fuqie organizative?
- A. Një avantazh i qëndrueshëm konkurrues është një forcë që është e vështirë të imitohet nga konkurrentët.**
 - B. Një fuqi nuk mund të dyfishohet lehtësisht, ndërsa një avantazh i qëndrueshëm konkurrues mund të kopjohet lehtësisht.
 - C. Çdo forcë çon në një avantazh të qëndrueshëm konkurrues.
 - D. Çdo avantazh i qëndrueshëm konkurrues çon në forcë.
33. Kostot e riparimeve të bëra nën garanci ose ndërrimit të produktit janë shembuj të:
- A. Kostove të parandalimit.
 - B. Kostove të vlerësimit.
 - C. Kostove të dështimit të brendshëm.
 - D. Kostove të dështimit të jashtëm.**
34. Kostot e inspektimit të lëndëve të para, testimit të mallrave gjatë gjithë procesit të prodhimit dhe testimit të produktit përfundimtar janë shembuj të:
- A. Kostove të parandalimit.
 - B. Kostove të vlerësimit.**
 - C. Kostove të dështimit të brendshëm.
 - D. Kostove të dështimit të jashtëm.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

35. Në mjedisin e trajnimit gjashtë-sigma, cili nga rolet e mëposhtme bazohet në motivimin e të tjerëve në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë në suksesin e organizatës?
- A. Breza të gjelbër.
 - B. Breza të zinj.
 - C. Mjeshtër me breza të zi.**
 - D. Sponsorët.
36. Inxhinieria sociale është një kërcënim për shënjesit (token) e përdorura për vërtetimin elektronik. Cila nga sa vijon është një kundërmasë për të zbutur kërcënimin e inxhinierisë sociale?
- A. Përdorni shënjesit (token) që gjenerojnë vërtetues me entropi të lartë.
 - B. Përdorni shënjesit (token) kriptografike harduerike.
 - C. Përdorni shënjesit (token) me autenticitet dinamikë.**
 - D. Përdorni shënjesit (token) me shumë faktorë.
37. Kontrolllet e autorizimit janë pjesë e cilave kontrolle nga sa vijon?
- A. Kontrolllet direktive.
 - B. Kontrolllet parandaluese.**
 - C. Kontrolllet e detektivëve.
 - D. Kontrolllet korigjuese.
38. Kriptimi (Encryption) është pjesë e cilave kontrolle nga sa vijon?
- A. Kontrolllet direktive.
 - B. Kontrolllet parandaluese.**
 - C. Kontrolllet e detektivëve.
 - D. Kontrolllet korigjuese.
39. Cila nga sa opsionet në vijim është e nevojshme kur zbatimi i politikave, procedurave dhe rregullave normale të sigurisë është i vështirë për t'u zbatuar?
- I. Kontrolllet kompensuese.
 - II. Mbikëqyrja e ngushtë.
 - III. Rishikimi i punës në ekip.
 - IV. Rishikimi i punës nga kolegët.
- A. Vetëm I
 - B. Vetëm II
 - C. I dhe II
 - D. Të gjitha më sipër**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

40. Forma e saktë e regjistrimit në ditar, të shitjes së një makineri të fabrikës, i cili u shit për një shumë parash që tejkalon vlerën e tij kontabël neto, është:

- A. Debi: Paraja
Debi: Fitimi nga shitja e makinerisë
Kredi: Makineria
Kredi: Zhvlerësimi i akumuluar i makinerisë
- B. Debi: Paraja
Debi: Fitimi nga shitja e makinerisë
Kredi: Makineria
- C. Debi: Paraja
Debi: Makineria
Kredi: Fitimi nga shitja e makinerisë
Kredi: Zhvlerësimi i akumuluar i makinerisë

- D. Debi: Paraja**
Debi: Zhvlerësimi i akumuluar i makinerisë
Kredi: Makineria
Kredi: Fitimi nga shitja e makinerisë

41. Një kompani ka bilancin e mëposhtëm provues para mbylljes më 31 dhjetor (shumat në Euro):

Paraja	80,000
Llogaritë e arkëtueshme	100,000
Inventari	230 000
Pasuritë fikse bruto	600 000
Zhvlerësimi i akumuluar	60 000
Llogari të pagueshme	200,000
Borxhi afatgjatë	1,000,000
Aksionet e zakonshme	2,000,000
Fitimet e pashpërndara (1 janar)	500,000
Të ardhura nga shitjet	750,000
Blerjet	530,000
Shpenzime administrative	200,000

Informacioni shtesë është:

Saldo fillestare e inventarit ishte 140,000 Euro.

Borxhi afatgjatë paguan interes në një normë prej 10% në vit, i pagueshëm çdo 12 muaj. Borxhi u emetua më 1 korrik të vitit aktual dhe fillimisht kishte pesë vjet deri në maturim.

Pasuritë fikse kanë një jetë të dobishme të vlerësuar 10-vjeçare dhe ishin një vit në fillim të vitit aktual. Kompani përdor zhvlerësimin e drejtpërdrejtë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

Cili është rendi i saktë i katër hapave të mëposhtëm në ciklin kontabël?

Hapi 1 - Përgatitni shënimet rregulluese në ditar.

Hapi 2 - Merrni një bilanc provues pas mbylljes.

Hapi 3 - Përgatitni një bilanc provues të rregulluar.

Hapi 4 - Përgatitni hyrjet e kundërta.

A. 1, 3, 2, 4.

B. 4, 1, 3, 2.

C. 3, 1, 2, 4.

D. 1, 2, 3, 4.

42. Cila nga opsionet e mëposhtme paraqet përfitim nga llogaritja e inflacionit në pasqyrat financiare?

A. Ai siguron automatikisht fonde për dividendë dhe zgjerim të prodhimit.

B. Ai ruan sistemin e kontabilitetit të bazuar në kosto historike.

C. Ai parashikon mirëmbajtjen e kapitalit fizik.

D. Ai identifikon fitimet dhe humbjet nga mbajtja e investimeve.

43. Në rakordimin e të ardhurave neto mbi bazën akruale me paranë neto të siguruar nga aktivitetet operative, çfarë rregullimi kontabël nevojitet për të ardhurat neto për shkak të (1) një rritjeje gjatë periudhës në shpenzimet e parapaguara dhe (2) amortizimit periodik të primit të obligacioneve të pagueshme?

A. Shto rritje në shpenzimet e parapaguara; Shto amortizimin e primit të obligacioneve të pagueshme

B. Shto rritje në shpenzimet e parapaguara; Zbrit amortizimin e primit të obligacioneve të pagueshme

C. Zbrit shpenzimet e parapaguara; Shto amortizimin e primit të obligacioneve të pagueshme

D. Zbrit shpenzimet e parapaguara; Zbrit amortizimin e primit të obligacioneve të pagueshme.

44. Cila nga sa vijon duhet të shpaloset në përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël?

A. Metoda e vlerësimit e përdorur për punën në proces të inventarit.

B. Interesi i kapitalizuar për periudhën.

C. Përshtatshmëria e aktiveve të planit të pensionit në lidhje me përfitimet e kushtëzuara.

D. Tarifat e amortizimit për periudhën.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

45. Një kompani është subjekt i pretendimeve nga garancionet e produkteve. Vlerësohet se ndoshta do të paguhen 1,000,000 deri 3,000,000 Euro. Asnjë vlerësim i humbjes brenda këtij intervali nuk ka më shumë gjasa për të ndodhur sesa çdo vlerësim tjetër. Kompania duhet:
- A. Të mos bëj asnjë shënim në ditar në këtë moment.
 - B. Të shpalos vetëm një humbje të mundshme.
 - C. Të shtyjë llogaritjen e një humbje prej 1,000,000 deri në 3,000,000 euro në varësi të standardeve kombëtare të kontabilitetit të zbatueshme.
 - D. Të llogarisë një humbje prej 1,000,000 deri në 3,000,000 euro në varësi të standardeve kombëtare të kontabilitetit të zbatueshëm.**
46. Në dhjetor 2021, janë printuar disa katalog për t'u përdorur në një promovim special në janar 2022. Katalogët u dorëzuan nga firma e printimit më 13 dhjetor 2021, me një faturë prej 70,000€ të bashkangjitur. PAGESA është bërë në janar, 2022. 70,000€ duhet të raportohen si një kosto e shtyrë në datën e bilancit të gjendjes më 31 dhjetor 2021 për shkak të:
- A. Parimit të përputhjes/harmonizimit.**
 - B. Parimit të realizimit të të ardhurave.
 - C. Parimit të objektivitetit.
 - D. Parimit të kostos.
47. Në regjistrimin e transaksioneve, cila nga të mëposhtmet përshkruan më mirë dallimin midis llogarive të shpenzimeve dhe llogarive të humbjeve?
- A. Humbjet janë ngarkesa të jashtëzakonshme ndaj të ardhurave ndërsa shpenzimet janë ngarkesa të zakonshme ndaj të ardhurave.
 - B. Humbjet janë zëra materiale ndërsa shpenzimet janë zëra jomaterialë.
 - C. Shpenzimet janë kosto të lidhura me të ardhurat, humbjet jo.**
 - D. Shpenzimet mund të parandalohen gjithmonë, ndërsa humbjet nuk mund të parandalohen kurrë.
48. Disa tregues ekonomikë e çojnë ekonominë në rimëkëmbje ose recesion, dhe disa e vonojnë atë. Një shembull i një variabël të vonës në zhvillim ekonomik do të ishte:
- A. Papunësia kronike.**
 - B. Porositë për mallra të konsumit dhe prodhues.
 - C. Ndërtimet e shumta të banesave/shtëpive.
 - D. Pritjet e konsumatorëve.
49. Dallimi mes një fitimi normal dhe një fitimi ekonomik është se një fitim ekonomik përfshin një shumë për të kompensuar:
- A. Të gjitha kostot e duhura të punës.
 - B. Rrezikun e marrë nga një sipërmarrës.**
 - C. Shumicën, edhe pse jo të gjitha, kostot e punës.
 - D. Kostot e punës, kapitalit dhe tokës.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

50. Dy variablat kryesore që kontribuojnë në rritjen e bruto produktit vendor real të një shteti janë produktiviteti i punës dhe:

- A. Përkufizimi i fuqisë punëtore.
- B. Norma e inflacionit.
- C. Cilësia e prodhimit.
- D. Orët totale të punës.**